




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



SHËRBIMI I PROVËS



QENDRA KOMUNITARE
të qëndrojmë së bashku

Nr. 1037/ prot., datë 21 . 07 .2025

Nr. 397/ prot., datë 22 . 07 .2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË PROVËS

dhe

QENDRËS KOMUNITARE “TË QËNDROJMË SË BASHKU”

Sot më datë 21.07. 2025, lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, me adresë: Rruga "Jordan Misja", Ndërtesa 6/1, Hyrja 1, Kodi postar 1016, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës (në mungesë), Drejtori i Mbikqyrjes Elektronike, **Z. Eris SHESHI**, këtu e në vijim "DPSHP"

dhe

Qendra Komunitare "Të qëndrojmë së bashku", institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, me adresë: Rruga "Sabaudin Gabrani", Kombinat, Misto Mame, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori **Znj. Eglisjana LAZE**, këtu e në vijim "Qendra".

Palët në këtë marrëveshje bashkëpunimi bien dakord për nënshkrimin e saj si më poshtë:

Neni 1 **Objekti i marrëveshjes**

Objekti i kësaj marrëveshjeje konsiston në vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe Qendrës Komunitare "Të qëndrojmë së bashku" për dhënien e asistencës sociale, këshillimit psiko- social, ofrimin e kurseve për formim profesional për personat nën mbikqyrje me dënime alternative në rastet e fëmijëve, të rinjve, individëve me nevoja të veçanta, me qëllim mbrojtjen e interesave të komunitetit, parandalimin e kryerjes së veprave penale, asistimin e tyre gjatë kryerjes së dënimit alternativ si dhe në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin e tyre shoqëror.

Neni 2 **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, në ligjin nr. 37/2017, datë 30.03.2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", në ligjin nr. 79/2020 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", në ligjin nr. 78/2020 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Provës" i ndryshuar, në VKM nr. 421, datë 08.07.2021 "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Shërbimit të Provës", në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 67, datë 12.06.2020 "Për riorganizimin e Qendrave Sociale në varësi të Bashkisë Tiranë, në Qendra Komunitare".

Neni 3 **Detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës**

1. DPSHP me anë të Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Tiranë njofton Qendrën për personat nën mbikqyrje ose të mitur në konflikt me ligjin të cilët kanë nevojë për shërbimet e ofruara nga Qendra me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e këtyre personave;
2. DPSHP garanton paraqitjen e specialistëve të Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Tiranë pranë Qendrës (të pajisur me dokumentin identifikues të lëshuar nga institucioni) për monitorimin e ecurisë së marrjes së shërbimeve të ofruara nga Qendra;

3. DPSHP garanton se specialisti i Shërbimit të Provës në ushtrimin e veprimtarisë së tij do të udhëhiqet nga ndershmëria, paanësia dhe profesionalizmi.

Neni 4

Detyrimet e Qendrës

1. Qendra merr përsipër të pranojë personat nën mbikqyrje, të miturit në konflikt me ligjin të referuar nga DPSHP sipas kapaciteteve pritëse të saj;
2. Qendra ofron shërbime sociale duke përfshirë regjistrimin dhe ndjekjen e mbështetjes në arsimin parashkollor dhe fillor, lehtësimin e trajnimit profesional, përgatitjen për tregun e punës, përfshirjen e fëmijëve në klasa arti, sporti dhe muzike, në gamën e lojrave në natyrë dhe ngjarjet relevante kulturore;
3. Qendra ofron shërbime këshilluese ndërmjetësuese lidhur me strehimin social, punësimin dhe riintegrimin social të personave të mësipërm.

Neni 5

Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet për një periudhë të pacaktuar nga dita e nënshkrimit dhe do të jetë efektive përgjatë kësaj periudhe.

Neni 6

Personat e kontaktit

1. Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje personat e kontaktit janë si në Aneksin 1.
2. Personat e caktuar në Aneksin 1, bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje, do të jenë përgjegjës për saktësinë e protokolleve, proces - verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqërues që do të dalë në zbatim të marrëveshjes.
3. Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar në Aneksin 1, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi, do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese të dhënat e personit të ri të kontaktit brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, të cilat njëkohësisht do t'i bashkëlidhen marrëveshjes nëpërmjet ankeseve.

Neni 7

Zbatimi i marrëveshjes

1. Palët marrin përsipër zbatimin e kësaj marrëveshjeje nga data e nënshkrimit të saj.
2. Për çdo problem gjatë zbatimit të marrëveshjes, palët marrin përsipër të komunikojnë midis tyre për zgjidhjen me mirëkuptim të të gjitha mosmarrëveshjeve që mund të rrjedhin gjatë zbatimit të saj.
3. Çdo ndryshim i akteve ligjore e nënligjore, për aq sa ato lidhen me këtë Marrëveshje, do të

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.


Neni 9
Dispozita të fundit

1. Çdo palë merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.
2. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.
3. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

PËR

**DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT TË PROVËS**

DREJTORI I PËRGJITHSHËM



PËR

**QENDRËN KOMUNITARE
"TË QËNDROJMË SË BASHKU"**

DREJTORI



Aneksi 1: Personat e Kontaktit.

Përfaqësues për Degën Territoriale të Shërbimit të Provës Tiranë:

Emër Mbiemër: Eristjana Karçanaj

Pozicioni: Specialist

Adresa: Rruga "Jordan Misja", pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Penale

Tel: +355 69 730 3014

Email: eristjana.karcanaj@sherbimiproves.gov.al

Përfaqësues për Qendrën Komunitare "Të qëndrojmë së bashku":

Emër Mbiemër: Sudorelle Karaj

Pozicioni: Përgjegjëse e Shërbimit

Adresa: Rr. Sahandini Gabresni, Misto Mame

Tel: 0682370673

Email: sudorellekaraj@gmail.com